



K.DH.SH.II.nr.481/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “....” Sh.p.k. me seli në Veternik-Prishtinë,të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Kushtrim Palushi avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, kundërvajtje doganore, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1941/18, të datës 27.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit, “....” Sh.p.k. me seli në Veternik-Prishtinë, e datës 26.01.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A.nr.1941/18, i datës 27.11.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, “....” Sh.p.k. me seli në Veternik-Prishtinë, ndërsa është lënë në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës nr. i datës 25.06.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet.

Gjykata Komerçiale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur nr. i datës 25.06.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, “....” Sh.p.k. me seli në Veternik-

Prishtinë, të ushtruar ndaj aktvendimit nr. i datës 24.05.2018, të lëshuar nga Sektori për Kundërvajtje Doganore.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit subjekti-tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizioni Fiskal. Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesorë më dt.18.11.2020, si në vështrim të nenit 41 të LKA, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lenë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, sipas theksimeve në arsyetim se: “Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se në procedurën administrative gjendja faktike është vërtetuar drejt kur është nxjerr konkluzioni se paditësi ka bërë deklaram të pasaktë në kuptim të kodit tarifor të mallit lëndor me anë të deklaratës, në emërtimin e parë dhe të dytë ka deklaruar mallin që e liron nga taksa doganore 7% dhe 4%, Sektori i Tarifës ka nxjerr mendimin për klasifikim tarifor nr....., sipas të cilit paditësi do të duhej të paguaj taksat doganore 7% dhe 4% dhe malli duhet të deklarohet në disa emërtime, ku me këtë veprim ka tentuar ti shmanget taksave doganore në fuqi. Sektori i Tarifës mendimin e vet e ka bazuar në rregullat e përgjithshme 1-6 për klasifikimin e mallrave, shënimet e seksionit XVI shënimin 2 (a), shënimet e kapitullit 84, shënimet 2 të seksionit XV, shënimet e kapitullit 73, shënimet sqaruese të nomenklaturës së kombinuar të krerëve përkatës, shënimet sqaruese të sistemit të harmonizuar HS, monstrave të fotografuara në ZBD Prishtinë, informative për klasifikimin nga vendet e EU-së, dhe informative të marra nga internet për produktet e ngjashme. Paditësi nuk ka provuar me asnjë dokument nga shteti eksportues apo prodhuesi i mallit lëndor, të ofroj informatat detyruese tarifore të mallit lëndor, që do të dëshmonin kodin tarifor të mallit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Kodit doganor dhe LPA, siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të LKA dhe LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare, si në vështrim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar - aktvendimit të DK, nr. i datës 25.06.2018, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sepse, nga dëshmitë e administruara ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim. Gjithashtu, kolegji vlerëson se Organi administrativ, e në rastin konkret DK, e ka shpallur përgjegjës paditësin për kryerjen e kundërvajtjes doganore nga neni 276 paragrafi k) të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, andaj Sektori për Kundërvajtje Doganore e ka obliguar paditësin të paguaj gjobën në shumë prej 500.00€ në bazë të ligjit për kundërvajtje nr. 05/L-087, neni 30 paragrafi 3, ku “në rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhërin kundërvajtës (afati prej 15 ditësh), i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shumata e gjobës së shqiptuar”.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtën e refuzon si të pabazuar dhe pa ndikim

për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse nuk dëshmohet se gabimisht është aplikuar e drejta materiale e po ashtu gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë në gjykatën e shkallës së parë dhe në organin përfundimtar të DK, se subjekti-paditësi mallin e deklaruar me anë të deklaratës, në emërtimin e parë dhe të dytë ka deklaruar mallin që e liron nga taksa doganore 7% dhe 4%, Sektori i Tarifës ka nxjerr mendimin për klasifikim tarifor nr., sipas të cilit paditësi do të duhej të paguaj taksat doganore 7% dhe 4% dhe malli duhet të deklarohet në disa emërtime.

Gjykata gjeti se bazuar në deklaratat e eksportit, janë përgaditur edhe faturat, në të cilat fatura prodhuesit i kanë përfshirë klasifikimin tarifor sikurse janë deklaruar nga "...", gjykata nuk e pranon si të drejtë për faktin se faturat nuk përgaditën mbi bazën e deklaratave eksportuese por viceversa deklaratat eksportuese përgaditen mbi bazën e faturave përcjellëse të mallit, tutje se në fatura është përfshirë kodi tarifor sikurse që është deklaruar me DUD-in, para se të kontestohet nga Dogana, nuk qëndëron, pasi që nga ekzaminimi i faturave nr.1812110024 datë 14.02.2018; dhe nr..... datë 08.02.2018, e të cilat janë të lëshuara për "... SHPK Tiranë Shqipëri, nuk janë të cekura edhe kodet tarifore të mallit, ndërsa situatë tjetër qëndëron në faturen nr. datë 04.01.2018, e cila ka në përshkrim numra të ndryshëm tarifor për pozicione apo lloje të ndryshme të mallit, e të cilët kode tarifore të mallit korrespondojnë në kuptim të krerëve dhe kapitujëve të TARIK-ut, me Mendimi mbi Klasifikimin Tarifor nr., dhe jo me atë siq i ka deklaruar vet këtu paditësi. Tutje nga ekzaminimi i faturës nr., nuk është kontestuese se të gjitha përshkrimet e mallit, edhe pse të llojeve të ndryshme, dhe atë nga pozicioni 01 e deri në 55, ju referohen vetëm një kodi tarifor, e që nuk është praktikë e Tarifës së Integruar të Kosovës, sepse sipas TARIK-ut llojet e ndryshme të mallit ndahen në kre dhe kapituj të ndryshëm, dhe si të tilla duhet të deklarohet në emërtime të ndryshme, por se të njejtat kode tarifore nga kjo faturë kontestuese nuk korrespondojnë as me vet faturën burimore nr. datë 04.01.2018, andaj Dogana ka vepruar drejtë kur bazuar në Mendimi mbi Klasifikimin Tarifor nr., ka ndryshuar kodet tarifore të mallit, andaj Sektori për kundërvajtje Doganore paditësit i ka shqiptuar gjobë administrative në vlerë prej 500.00€, pasi që subjekti në procedurë ka rënë në kundërshtim me nenin 276 pika k) të KDAK-së.

Gjykata duke i pasur parasysh dispozitat ligjore të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku shprehimisht parashihen dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore e ku në mes tjerash në paragrafin 1, pika C thuhet; "*Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruara*", konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura të ofrojë prova konkrete për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar, për vendosje të mallit lëndor në qarkullim të lirë, gjë të cilën nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi nuk e ka bërë, e sidomos në rastet kur në kodin tarifor të deklaruar sipas TARIK-ut aplikohet lirime nga detyrimet doganore.

Kolegji konstaton se në rastet kur nuk kemi Informatë Tarifore Detyruese të autoriteteve nga shteti eksportues apo i origjinës të deklaruar nga paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallit dhe/apo shqyrtimit gjyqësor atëherë e paditura me të drejtë është bazuar në Mendimin për Klasifikim Tarifor n., të dhënë nga Sektori i Tarifave për mallra identike apo të ngjashme i cili vepron në kuadër të paditurës dhe i konfirmuar nga gjykata e shkallës së parë. Informacioni tarifor i detyrueshëm gjen zbatim me nenin 18, par 1 dhe 2, të KDAK-së, dhe do të jetë detyrues për Doganën ndaj personit të cilit i është lëshuar informacioni vetëm lidhur me klasifikimin tarifor të

mallit, dhe se Informacioni tarifor i detyrueshëm është detyrues vetëm lidhur me mallrat, për të cilat formalitetet doganore janë përfunduar pas datës në të cilën janë pajisur me informata.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË

K.DH.SH.II.nr.481/22, me datë 06.10.2022

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**